



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ANALIZA E TREGUT TË ARRËS



Shtator, 2021

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE
STATISTIKAVE BUJQËSORE

ANALIZA E TREGUT TË ARRËS

Shtator, 2021

Parathënie

Arra është njëra ndër kulturat bujqësore që bënë pjesë në grupin e arroveve, mjaft e shëndetshme dhe është një burim i shkëlqyer i proteinave, yndyrave, fibrave, etj. Ngritja e një plantacioni arre sjellë të ardhura të mira, është e lehtë të kultivohet dhe mirëmbahet.

Kultivimi i arrës nuk kërkon shumë angazhim, fruti është mjaft i kërkuar dhe lehtë e gjen tregun. Arra mund të konsumohet si frut i pjekur, por edhe pjesë të tjera të arrës si gjethja dhe mbështjellësi i gjelbër përdoren në industri farmaceutike dhe atë të ngjyrave. Ka një jetëgjatësi mbi 100 vjeçe dhe përveç dobive tjera druri i arrës është një ndër drunjtë më të rëndësishëm dhe më të kërkuar në industrinë e drurit. Në përgjithësi ky përdorim shumë dimensional i arrës e bënë arrën një kulturë me vlerë të lartë ekonomike. Nuk ka probleme me ngricat përveç atyre të hershme pranverore dhe nuk sulmohet nga shumë sëmundje. Një e metë në kultivimin e arrës është se fillon të japë fryte në vitin e tretë, por rendimentet komerciale mund të priten vetëm nga viti i shtatë deri në vitin e dhjetë, dhe rendimenti i plotë nga viti i dymbëdhjetë. Duke pasur parasysh çmimin e leverdishëm mund të themi se paraqet njërën ndër kulturat me rëndësi strategjike që ka mundësi të shtimit të sipërfaqeve, rritjen e prodhimit dhe njëherit eksportin e këtij produkti në vende të ndryshme. Duke u nisur nga fakti se kjo kulturë ka zinxhir të gjerë të përpunimit (klasifikim, tharje, paketim, përpunim i vajit, përpunim i gjalpës dhe forma tjera), mund të themi se kultivimi i arrës kontribuon dukshëm në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe zhvillimit ekonomik në zonat rurale por edhe më gjerë.

Arra është ndër kulturat me kthim shumë të ngadaltë të investimeve, por paraqet mundësi për zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara, tregtimin për nevoja të tregut lokal e po ashtu edhe për tregjet e huaja si e qëruar apo e pa qëruar. Duke u nisur nga rëndësia ekonomike e arrës, Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore ka përgatitur këtë publikim me qëllim të ofrimit të informatave, ku janë të përmbledhura të dhënat për tregun e arrës në Kosovë. Në këtë analizë paraqiten të dhënat për sipërfaqen e arrës, prodhimtarinë vendore, çmimet vendore dhe të importit, madhësinë e tregut, mbështetjen e kulturës së arrës si dhe konkluzionet e përgjithshme.

1 Tregu i arrës

Arra është duke u përhapur së kultivuari edhe në vendin tonë pasi që dita ditës po dëshmohet se është një ndër kulturat më profitabile. Edhe pse është e kultivuar në sipërfaqe të vogël, arra ka mundësi të mëdha të shtrirjes dhe zgjerimit në tërë territorin e Kosovës, bazuar në kushtet e favorshme natyrore që posedojmë. Me shtimin e sipërfaqeve pritet të shtohet edhe prodhimi vendor, gjë që bënë të mundur që një sasi e arrës edhe të eksportohet.

Sipërfaqja e kultivuar me arrë është rritur dukshëm ndër vite. Të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë të vitit 2014 tregojnë se sipërfaqja e mbjellur me arrë ishte 48 ha, ndërsa në vitin 2020, të mbjellura me arrë ishin 1,295 ha, që paraqet një rritje të sipërfaqeve për 27 here. Duke qenë se prodhimtaria vendore e arrës nuk është e mjaftueshme, një sasi e konsiderueshme importohet.


2 Prodhimtaria vendore

Duke filluar nga viti 2015, kur ishin të mbjellura 177 ha me arrë, trendi i rritjes graduale të sipërfaqes vazhdoi edhe në vitet në vijim. Në vitin 2016 ishin të mbjellura 186 ha, në vitin 2017 ishin 340 ha, duke vazhduar me trend të rritjes edhe në vitin 2018, me sipërfaqe prej 797 ha.

Në vitin 2020, sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në vendin tonë ishte 10,265 ha. Nga

kjo sipërfaqe me arrë ishin të kultivuara 1,295 ha, që do të thotë se arra kishte pjesëmarrje prej 13% të sipërfaqes së përgjithshme të mbjellur me pemë. Kështu që nisur nga të dhënat statistikore, zgjerim më i madh i sipërfaqes shfaqet në vitin 2020 me 1,295 ha, që paraqet rritje për 46% krahasuar me vitin 2019.

Figura 1: Sipërfaqja e kultivuar me pemë dhe arra (ha), 2015-2020




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Prodhimtaria e arrës në vitin 2015 ishte vetëm 323 tonë, duke vazhduar me rritje në vitin 2016 me sasi të prodhimit prej 470 tonë. Rritje më të madhe të prodhimit kishte në vitin 2019 (2,028 t) dhe në vitin 2020 (2,591 t). Normalisht rritja e prodhimit shkon paralelisht me rritjen e sipërfaqeve

sidomos në 2 vitet e fundit. Meqenëse këto sipërfaqe kryesisht janë të mbjella kohëve të fundit dhe të njëjtat ende nuk kanë filluar të hyjnë në prodhim të plotë, përkundër rritjes së sipërfaqes sasia e prodhimit është ende e vogël.

Figura 2: Prodhimtaria e arrës në tonë, 2015-2020




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Rendimenti i arrës në vitin 2015 ishte 1.82 tonë/ha, duke vijuar me rritje të rendimentit në vitin 2016 në 2.52 t/ha. Në vitin 2017 si rezultat i ngricave të hershme pranverore ka pasur rënie të rendimentit të arrës, që ishte 1.19 tonë/ha. Rritje të

rendimentit të arrës kishte në vitin 2019 (2.29 t/ha), duke shënuar rënie në vitin 2020 (2.00 t/ha). Ky është një rendiment mjaft i ulët kur dihet fakti se në kushte normale rendimenti i arrës në plantacione komerciale mesatarisht arrin mbi 3 t/ha.

Figura 3: Rendimenti i arrës (tonë / ha), 2015-2020



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

3 Zhvillimi i tregtisë

Me një prodhimtari prej 2,591 tonë që ishte në vitin 2020, Kosova nuk i përmbush kërkesat vendore të konsumit me arrës. Meqenëse kërkesat janë mjaft të mëdha, pjesa tjetër e kërkesave përmbushet me importimin e një sasive të arrës nga vendet e ndryshme. Kultivimi i arrës tek ne përkrahet përmes pagesave direkte. Për zgjerim të sipërfaqeve të mbjellura me arrë përveç përkrahjes së nivelit qendror,


gjithashtu ka pasur përkrahje edhe nga niveli komunal. Kultivuesit e arrës përkrahje kanë gjetur edhe nga shoqata e kultivuesve të arrës dhe lajthisë. Në vitin 2020 prodhimi i përgjithshëm i arrës ishte 2,591 tonë dhe po ashtu janë importuar 84 tonë, ku në këtë rast gjithsej sasia e arrës në treg ishte 2,675 tonë. Eksport nuk ka pasur në vitin 2020.

3.1 Importi i arrës

Figura në vijim prezanton importin e arrës në vlerë dhe sasi për vitet 2017-2020. Vlera e importit të arrës në vitin 2017 ishte 612 mijë €, duke vazhduar me rritje deri në vitin 2019 kur vlera e importit të arrës arriti 1.2 mil. € në vit. Në vitin 2020 kishte rënie në vlerë në importin e arrës për 73%, pasi që edhe sasia ishte shumë e vogël.

Në vitin 2017, sasia e importit të arrës ishte 235 tonë, duke shënuar rritje në vitin 2019 që ishte 428 tonë. Në vitin 2020 kjo sasi është mjaft e vogël krahasuar me vitin paraprak ku shfaqet një rënie prej 80% krahasuar me vitin 2019. Mesatarja e çmimit për njësi të importit (arra të qëruara dhe të paqëruara) në vitin 2020 ishte 4.2 €/kg.

Figura 4: Importi i arrës, sasia në tonë dhe vlera në '000 €, 2017-2020




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

Në figurën 5 janë prezantuar vendet kryesore prej nga Kosova importon arrën. Vlera e importit të arrës është paraqitur për periudhën 4 vjeçare, ku vërejmë se importi më i madh i arrës vjen nga Ukraina me

pjesëmarrje mbi 50% të importit (përfshirë vitin 2018). Shtete tjera me pjesëmarrje më të vogël në importin e arrës ishin Bullgaria, Rumania, Kina dhe vendet tjera që janë paraqitur në figurat në vijim.

Figura 5: Vlera e importit të arrës 2017-2020, sipas vendeve (%)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Siç mund të vërejmë nga të dhënat e shfaqura në figurën 6, në vitin 2020 vlera e importit të arrës ka qenë më e vogël meqenëse edhe sasia e arrës ishte po ashtu më e vogël se sa tre vitet e fundit. Muaji me

vlerë më të lartë të importit ishte muaji prill (114 mijë €), muaji mars (93 mijë €) dhe muaji nëntor (40 mijë €), ndërsa në muajt tjerë vlera e importit ishte më e vogël.

Figura 6: Vlera e importit të arrës sipas muajve, 2017-2020, (në '000 €)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2020 gjithsej sasia e arrës së importuar ishte 84 tonë ndërsa importi sipas muajve ishte në këtë shpërndarje: gjatë muajit mars kishte import në sasi prej 22 tonë, muaji prill 23 tonë dhe në muajin

nëntor u importuan 23 tonë. Në vitin 2020 për dallim nga vitet tjera kemi 2 muaj, muaji maj dhe muaji tetor ku importi i arrës ishte në sasi më pak se gjysmë toni.

Figura 7: Sasia e importit të arrës sipas muajve, 2017-2020, (tonë)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

3.2 Bilanci tregtar i arrës

Nga të dhënat e prezantuara rrjedh se bilanci tregtar i arrës gjatë periudhës 2017-2020 është negativ. Vlerë më e madhe e importit paraqitet në vitin 2019, që ishte

1, 289 €. Në vitin 2020 importi kishte rënie për 73% në krahasim me vitin 2019. Meqenëse këtu bëhet fjalë për arrën që gjendet në treg si arrë e qëruar e terur dhe

e paketuar dhe gjithashtu edhe si arrë e paqëruar me lëvozhgë apo pa lëvozhgë, çmimi ka dallim të madh mes këtyre kategorive, prandaj vlera është mesatarja e dy kategorive. Përkundër importit sasia e

eksportit të arrës ka qenë shumë simbolike. Kështu që duhet të ceket se eksport ka pasur vetëm në vitin 2019 në sasi prej 0.37 tonë arra, që kishin vlerë 2,066 €, dhe me çmim për njësi të eksportit 5.6 €/kg.

4 Çmimet e tregut

Nga prodhimtaria vendore arra në vitin 2020 kishte rendiment prej 2 tonë për ha, me ç'rast nga sipërfaqja prej 1,295 ha prodhimtaria e arrës ishte në sasi prej 2,591 tonë, që paraqet sasi të pa mjaftueshme për tregun vendor. Në mungesë të prodhimit vendor importohet sasi e konsiderueshme

e arrës. Për këtë arsye edhe çmimi i arrës së qëruar dhe të paketuar është mjaftë i lartë.


Në vendin tonë sidomos viteve të fundit tregu i arrës është duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme. Rritja e sasisë së prodhimit të arrës ndikon në uljen e çmimeve të arrës në treg

4.1 Çmimet në tregun vendor

Në vitin 2017, çmimi i arrës së paqëruar me shumicë ishte 2.7 €/kg, duke vazhduar me rritje deri në vitin 2018 kur çmimi ishte 2.8 €/kg. Çmimi më i ulët ishte 2.3/€ në vitin 2019, që paraqet vitin me import më të madh të arrës krahasuar me vitet tjera, duke vazhduar me rritje në vitin 2020 në 2.4

€/kg. Sa i përket çmimit me pakicë më i ulëti ka qenë në vitin 2020 në vlerë prej 2.6 €/kg, kurse si çmim më i lartë ishte 2.9 €/kg në vitin 2017 dhe 2018. Në figurën nr. 9 janë paraqitur çmimet e tregut vendor të arrës së paqëruar me shumicë dhe pakicë €/kg.


Figura 8: Çmimet e tregut vendor të arrës së paqëruar, 2017-2020, €/kg



Çmimi mesatar më i ulët në fermë për arrën e paqëruar ishte në vitin 2020 në vlerë prej

2.06 €/kg, e si çmim më i lartë ishte në vitin 2018 (2.72 €/kg).

Figura 9: Çmimi për arrën e paqëruar në fermë, 2017-2020, €/kg




Burimi: SIT, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2 Çmimet e importit

Si edhe tek kulturat tjera po ashtu edhe te arra shfaqet luhatje e çmimit nga viti në vit, gjë që varet nga sasia e prodhimit të arrës që gjendet në treg. Mesatarja e 5 viteve e çmimit vendor me shumicë i arrës së qëruar ishte 10.2 €/kg, kurse mesatarja e çmimit të importit me shumicë i arrës së qëruar ishte 9.9 €/kg. Mesatarja e 5 viteve e çmimit të

importit të arrave të qëruara vendore me pakicë ishte 11.6 €/kg, përderisa çmimi i importit me pakicë ishte 11.2 €/kg. Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurën 11 vërehet se nuk ka shumë dallime të theksuara mes çmimit vendor të arrës së qëruar dhe atyre të importit.

Figura 10: Çmimi mesatar i arrës së qëruar në treg, vendore dhe të importuar, 2017-2020



Burimi: SIT, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

5 Madhësia e tregut

Arra karakterizohet me një përdorim të gjerë që në përgjithësi sjell përfitime të shumta ekonomike. Këtu mund të përmendim frutin që edhe kur është i gjelbër mund të përdoret për qëllime farmaceutike, degët, gjethet lëvorja dhe posaçërisht druri i arrës i cili përdoret në industrinë e prodhimit të mobileve, atë të avionëve dhe automobilave. Arra përveç që përdoret si frut i pastër mund të përdoret si gjalpë, vaj, e kombinuar me mjaltë, në industrinë e ëmbëlsirave si dhe kulinari. Madhësia e tregut të përgjithshëm të arrës në Kosovë në vitin 2020 duke përfshirë prodhimtarinë vendore dhe importin vlerësohet të jetë 2,675 tonë, nga e cila sasi 2,591 tonë janë prodhimtari vendore dhe 84 tonë arrë janë importuar.


Arra është e pranishme në treg gjatë gjithë vitit meqenëse edhe mund të ruhet si frut për një kohë më të gjatë. Kultivarët më të përhapur të arrës në vendin tonë janë: Chandler, lulëzojnë me vonesë, ndaj janë

më rezistente ndaj ngricave pranverore sesa llojet e tjera. Fernor është një varietet Francez që çel me vonesë, rekomandohet më shumë për klima të ftohta. Franketa është lloj që çel me vonesë dhe është shumë rezistente ndaj të ftohtit.

Varësisht nga forma e mbjelljes dhe kultivari (mbjellja në katror apo zik-zake) nëse mbjellët varieteti Chandler kryesisht për një ha mbillen 285-333 bimë. Një fidan kushton mesatarisht 6-12 €, varësisht prej vjetërsisë dhe gjatësisë së fidanit dhe vendit prej nga vjen. Në Kosovë kryesisht fidanet e shartuara të varietetit Chandler importohen nga Turqia, por ka import edhe nga Italia, Kroacia edhe nga Serbia.

Në figurën nr. 13 është paraqitur rendimenti mesatar i kultivimit të arrës për 11 vite. Viti i parë dhe i dyti nuk ka fare prodhim, nga viti tretë paraqitet sasi shumë e vogël e prodhimit duke u rritur prodhimi deri në vitin e 11 kur edhe arrihet rendimenti i plotë i arrës.

Figura 11: Rendimenti kg/ha, nga viti i parë deri në vitin e 11-të



Burimi: DAESB, në bashkëpunim me ekspertë të fushës

5.1 Ndikimi i prodhimit të arrës në punësim dhe mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës

Numri i fermerëve në vitin 2020 që kultivojnë arrë dhe kanë aplikuar për subvencione është 745. Sipërfaqja e kultivuar në vitin 2020 është 1,295 ha. Bazuar në numrin e aplikuesve për subvencione sipërfaqja mesatare e kultivuar me arrë është 0.6 ha. Disa biznese në Kosovë kanë filluar të merren me klasifikimin, paketimin, dhe përpunimin

në forma të ndryshme siç është vaji i arrës dhe gjalpë. Kështu që në të ardhmen e afërt mbyllja e zinxhirit të prodhimit mund të hapë vende të reja të punës. Sipas përllogaritjeve për sipërfaqen ekzistuese prej 1,295 ha, për mirëmbajtje të plantacionit pas vitit të parë mund të angazhohen afërsisht 1,300 persona.

6 Mbështetja e prodhimtarisë së arrës

6.1 Pagesat direkte për arrë

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sipërfaqeve të tokës bujqësore të mbjellura me pemë do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me pemë, ndalimin e migrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi. Fermerët të cilët kultivojnë pemë për të qenë përfitues nga programi i pagesave direkte duhet të jenë shtetas të

Republikës së Kosovës, kultivuesit e arrës për të përfituar nga programi i pagesave direkte duhet të kenë të mbjellura së paku 0.50 ha, parcela e mbjellur në pronësi apo e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë, sipërfaqja e pemishtes së kontraktuar duhet të jetë së paku për një vit, pemishtja duhet të jetë e mirëmbajtur (e lëvruar ose e mbjellur me bari në mes të rreshtave, e krasitur, e mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve-rreshtave.

Subvencionimi në formë të pagesave direkte bëhet për sipërfaqe (ha) të mbjellur, në vlerë prej 400 €/ha.

6.2 Masat e zhvillimit rural që përkrahin sektorin e pemëve-arrën

Në kuadër të masave të zhvillimit rural në vitin 2020 kultura e arrës është përkrahur në kuadër të masës 101, Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore. Fermerët në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 1 ha, sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.35 ha. Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë 11 fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e

certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit. Gjithashtu fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100,000 €. Përveç në kuadër të masës 101, sektori i pemëve - arra përkrahët edhe në kuadër të masës 103, Investimet në asetet fizike në

përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 30,000 €, ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 400,000 €. Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit. Përveç masës 101 dhe 103 sektori i pemëve përkrahet edhe në kuadër të masës 302, "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve". Masa 302 "Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve" synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe ruajtjen e atyre ekzistuese. Në kuadër të investimeve të pranueshme hyjnë:

ndërtimi/renovimi/zgjerimi i objekteve për prodhim, ruajtje dhe përpunim të prodhimeve, investimet në makina dhe pajisje për përpunimin e pemëve dhe perimeve, klasifikim, grumbullim, ruajtje, frigorifer me ftohje, me ngrirje etj, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nën masat e kësaj mase është 5,000 €. Përkrahja publike është 65% e shpenzimeve të pranueshme të investimit. Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore.

7 Promovimi dhe sfidat

Me qëllim të promovimit të vlerave ushqyese të arrës, përfitimet që vijnë nga kjo kulturë dhe mundësia e zgjerimit në tërë territorin e Kosovës, nga Shoqata e Kultivuesve të arrës është organizuar dita e arrës. Ky manifestim organizohet çdo vjet dhe nuk ka lokacion të caktuar por organizohet aty ku arra si kulturë kultivohet me sukses. Është shumë e rëndësishme që arra të promovohet sa më tepër meqenëse është kulturë që ka potencial të zhvillimit dhe ka nevojë për inkurajimin e fermerëve të rinj që të kultivojnë sa më shumë arrën. Po ashtu

rëndësi për promovimin e arrës ka pjesëmarrja e prodhuesve vendor në panairë të produkteve bujqësore që organizohet çdo vit radhazi. Si për çdo kulturë tjetër edhe tek arra vështirësi kryesore gjatë kultivimit të arrës është sigurimi i fidanëve cilësorë të prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare, ku në raste të caktuara ka pasur edhe dështim të sipërfaqeve të mbjellura me arrë. Sfidë tjetër në kultivimin e arrës është vështirësia në sigurimin e sistemit të ujitjes dhe dëmet që vijnë nga kushtet klimatike.

8 Konkluzionet

Në bazë të të dhënave të prezantuara mund të konkludojmë se arra është kulturë me potencial të lartë konkurrues, përmes të cilës mund të realizohen të ardhura të konsiderueshme.

Sipërfaqet me arrë në vendin tonë po zgjerohen dita ditës pasi që fermerët po e shohin si kulturë me leverdi për tregun vendor dhe të jashtëm dhe në të njëjtën kohë po krijohen vende të reja të punës.

Arra kultivohet më lehtë se sa pemët tjera, ka vlerë të lartë në treg dhe po ashtu varësisht nga kultivarët mund të ruhet për një kohë më të gjatë duke i ruajtur vlerat ushqyese.

Veçori pozitive e arrës është se ajo mund të kultivohet edhe e përzier me pemë të tjera e po ashtu mund të kultivohet edhe në zona që kanë lartësi më të madhe mbidetare.

Duke pasur parasysh çmimin e përshtatshëm, arra paraqet njërën ndër kulturat me rëndësi strategjike për vlerën e lartë ushqyese që ka.

Gjatë zgjerimit të sipërfaqeve me arrë, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet llojit të varietetit të arrës që kanë lulëzim të vonshëm dhe nuk shkaktohen dëme nga ngricat e vonshme pranverore.

Bazuar në elementet klimatike mund të themi se Kosova ka kushte ideale për kultivim të arrës, përveç zonave ku ka

lagështi në lugina rreth liqeneve dhe lumenjve.

Me qëllim të ofrimit të informatave të nevojshme për kultivuesit e arrës është krijuar shoqata e kultivuesve të arrës e cila merret me informimin rreth kultivimit të kësaj kulture ku interesimi tyre po rritet dita e ditës.

Shoqata organizon çdo vit ditën fushore të arrës në vende të ndryshme të Kosovës ku kultivohet arra, ku pastaj fermerët i ekspozojnë arrat, rritet bashkëpunimi mes tyre, fitojnë çmim më të mirë dhe në të njëjtën kohë mund ti shesin ato.

Vështirësi e madhe për prodhuesit vendor është sigurimi i materialit të pastër fidanor të certifikuar, ruajtja e frytit për një periudhë më të gjatë kohore në standarde të duhura.

Duke përdorur arrën vendore si lëndë të parë mund të krijohen ndërmarrje të vogla dhe të mesme për përpunimin e arrave, duke bërë të mundur mbylljen e zinxhirit të prodhimit që paraqet trekëndëshin e bashkëpunimit mes fabrikës, kooperativës dhe fermerëve. Njëkohësisht do të mund të angazhohen një numër i madh i fuqisë punëtore kryesisht nga zonat rurale ku edhe ka potencial të promovohet turizmi rural.